



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2023:244989  
Datë: 10.10.2024  
Numri i dokumentit: 06282576

K.DH.SH.II.nr.1125/24

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër debitorit NP “DC Office”, me NRB: 70686457, me adresë rruga “Hyzri Talla” pn, Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1856/23 të datës 14.02.2024, me datë 10.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit NP “DC Office” me seli në Fushë Kosovë, e datës 29.04.2024, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1856/23 të datës 14.02.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1856/23 të datës 14.02.2024, ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit NP “DC Office” i paraqitur kundër Urdhrit

Përmbarrimor P.nr.347/16 të datës 23.08.2016 i lejuar nga Përmbarruesi Privat Arsim Bajraktari dhe i njëjti Urdhër mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, duke konsideruar se propozimi për përmbarrim sipas vendimit të Doganës së Kosovës është i pa bazuar, andaj kërkon nga Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Dytë të merr vendim në pezullimin e vendimit të Doganës për dënim të biznesit i cili nuk është përgjegjës për caktimin e kodeve doganore dhe prapësimin për kundërvajtje ngas përmbarruesi privat.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit NP "DC Office" me seli në Fushë Kosovë, në bazë të dokumentit përmbarrues-aktvendimit të Sektorit të Kontrollës Pas Importuese nr.08.1.2/903 të datës 13.05.2015 duke e obliguar debitorin që ti paguaj kreditorit shumën në vlerë prej 800.00€ në emër të kundërvajtjes doganore.

Përmbarruesi Privat Arsim Bajraktari, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.347/16 të datës 23.08.2016, e ka caktuar përmbarrimin në bazë të dokumentit përmbarrimor, ndërsa debitori me datë 06.01.2022, ka parashtruar prapësim, duke pretenduar se urdhri për përmbarrim të cilin e kontestojnë është në tërësi i pa bazuar dhe se debitori DC Office nuk pajtohet me aktvendimin në bazë të cilit obligohet të paguaj gjobën prej 800.00€. Andaj propozojmë që Dhoma e Shkallës së Dytë të merr parasysh provat, dëshminë lidhur me aktvendimin e cilësuar si kundërvajtje për DC Office, gjobën e përcaktuar prej 800 euro dhe të liroj DC Office si biznes nga dënimi apo gjoba në shumë prej 800.00€.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1856/23 të datës 14.02.2024, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se Aktvendimi 08.1.2/903 i datës 13.05.2015, i nxjerrë nga Dogana e Kosovës, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi 08.1.2/903 i datës 13.05.2015, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbartueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi 08.1.2/903 i datës 13.05.2015, i nxjerrë nga Dogana e Kosovës, është dorëzuar në origjinal, si dhe është bërë i formës së prerë me datën 10.08.2015 dhe i ekzekutueshëm me datë 10.09.2015, e cila vërtetohet nga vula e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë. Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se nuk pajtohet me Aktvendimin në bazë të cilit debitori obligohet ta paguaj gjobën prej 800.00 Euro, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të së cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje

thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Aktvendimi Nr.08.1.2/903 i datës 13.05.2015, është dokument përmbartues dhe i përshtatshëm për përmbartim, për faktin se me nenin 21 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, në të cilin përcaktohet se “ *Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshme, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*” dhe neni 22 par.1 pika 1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë “*Vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi*”. Në rastin konkret Vendimi me Nr. 08.1.2/903 i datës 13.05.2015 i përmban elementet e një vendimi të organit administrativ , dhe se e ka cilësinë e dokumentit përmbartues sipas nenit 21 dhe 22 par.2, LPP-së.

Andaj, Gjykata Komerciale – dhoma e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur kur e ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se vendimi mbi të cilin përmbartuesi privat e ka lejuar urdhrin përmbartimor të debitorit me Nr. 08.1.2/903 i datës 13.05.2015 paraqet dokument përmbartimor në kuptim të dispozitave të LPP-së, për shkak se përmban vulën e ekzekutueshmëris datës 10.09.2015 dhe plotfuqishmërisë datës 10.08.2015, si dhe vendimi mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri përmbartimor i plotëson kushtet në kuptim të nenit 22 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimor.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se;

*“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për*

*përmbaryeshmëri ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ Vërtetimin për përmbaryeshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbaryim.*

Gjykata vlerësoj pretendimet ankimore të debitorit por të njëjtat janë shqyrtuar edhe nga gjykata e shkallës së parë me të cilën ka dhënë arsyetime të mjaftuar të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë ngase pretendimet e tilla nuk janë objekt të shqyrtimi në procedurën përmbaryimore, kështu që nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit rigorozitetit formal, në bazë të së cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përveq vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbaryimi si dhe përshtatshëmrisë së vendimit si objekt përmbaryimi.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të debitorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitorë për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përmbaryimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II.nr.1125/24, me dt.10.10.2024**

Gjyqtarja  
Franciska Zhitija Ymeri